

BULETIN INFORMATIV

Janar - Dhjetor 2008

KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Dhjetor 2008



Fjala hyrëse nga Kryetarja e Komisionit



Realiteti i ri në Kosovë, dhe përkushtimi i institucioneve dhe shoqërisë së Kosovës për integritime evropiane, ka bërë të domosdoshme krijimin e Komisionit për Integritime Evropiane nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Aktivitetet e ngjeshura në drejtim të përgatitjes së Kosovës për integritime euroatlantike të këtij Komisioni, kanë arsyetuar formimin e tij.

Pas definimit të rolit të tij në procesin e integritimit evropian të Kosovës, puna e Komisionit gjatë vitit 2008, ishte fokusuar në tre drejtime kryesore: në sigurimin e përputhshmërisë së legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e UE-së; në monitorimin e Qeverisë për përmbushjen e standardeve evropiane për integritim dhe në diplomaci parlamentare.

Për të siguruar përputhshmërinë e legjislacionit kosovar me atë të UE-së, Komisioni ka shqyrtuar të gjitha projektligjet dhe amendamentet e komisioneve funksionale. Për të siguruar që puna e qeverisë në drejtim të integritimit evropian të Kosovës është në rrugë të duhur dhe për ta nxitur atë në këtë rrugë, Komisioni për Integritime Evropiane rregullisht ka ftuar përfaqësues të Qeverisë. për të raportuar për punën e tyre dhe progresin e arritur. Ndërkaq, përmes diplomacisë parlamentare, Komisioni ka synuar të përfitoj nga përvoja e shteteve të tjera që kanë ndjekur rrugën e integritimit si dhe të siguroj vazhdimin e mbështetjes për Kosovën nga institucionet e UE-së. Për këtë qëllim gjatë vitit 2008, komisioni ka realizuar tri vizita të suksesshme jashtë shtetit (Tiran, Zagreb dhe Bruksel).

Meqë Komisioni ynë do të ketë rol kyç në vitet në vazhdim, për integritim të suksesshëm në strukturat euroatlantike dhe për të përmbushë me sukses rolin e tij, është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës të rris mbështetjen e tij me staf profesional dhe të siguroj hapësirë më të madhe për punë. Gjithashtu Komisioni e vlerëson mbështetjen e deritanishme të partnerëve të jashtëm (si Zyra Ndërlidhëse e Komisioni Evropian, NDI, OSBE) dhe pret që kjo mbështetje të vazhdoj edhe më tutje.

Zylfije Hundozi

Kryetare e Komisionit



FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

Komisioni Parlamentar për Integritime Evropiane është njëri nga 11 komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës. Përbëhet nga 11 anëtarë që përfaqësojnë partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Në bazë të përshkrimit të detyrave, puna e këtij Komisioni konsiston në: monitorimin e procesit të harmonizimit të



sistemit juridik të Kosovës me sistemin juridik të Unionit Evropian; monitorimin e procesit të harmonizimit të legjislacionit me *acquis communautaire*; shqyrtimin e projektligjeve të iniciuara për miratim nga Kuvendi, nga aspekti i përafrimit

dhe përputhshmërisë së legjislacionit me *acquis communautaire*; bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet e Unionit Evropian në drejtim të integritimit dhe anëtarësimit të Kosovës në Unionin Evropian; bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet e UE-së dhe shteteve tjera lidhur me integritimin në UE; bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet evropiane në Kosovë; mbikëqyrjen e zbatimit të *Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE)*; participimin dhe mbikëqyrjen e Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit të Kosovës; mbikëqyrjen dhe koordinimin e procesit të ashtuquajtur *“Pre-accession Assistance (IPA)”*; monitorimin e programeve donatore dhe të kooperimit të UE-së të dedikuara Kosovës; monitorimi i zbatimit të detyrimeve të Kosovës të dala nga konventat e Këshillit të Evropës; monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për Kosovën.

PLANI PUNËS 2008

Komisioni për Integritime Evropiane është ndër komisionet e para që ka miratuar Planin e Punës. Për shkak të specifikave që ka ky Komision, fillimisht ka miratuar Planin gjashtë mujor mars - shtator 2008, të cilit iu është përmbajtur me përpikëri. Pas përmbushjes së Planit gjashtë mujor, Komisioni për IE ka miratuar Planin e punës shtator - dhjetor 2008. Në hartimin e Planit, Komisioni



kishte marrë parasysh, përveç Strategjisë Legjislative të Qeverisë edhe nevojën për monitorimin e zbatimit të obligimeve të Qeverisë për përmbushjen e standardeve të UE-së si dhe ofrimin e mbështetjes për procesin e integritimeve evropiane të Kosovës.



TAKIMET E KOMISIONIT

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni mban së paku 2 takime në muaj. Gjatë vitit 2008, ky Komision ka përmbushur obligimet e parapara, madje i ka tejkaluar ato. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2008 ka mbajtur *25 takime, 3 vizita jashtë shtetit* si dhe *1 tryezë* të rrumbullakët për procesin e integritimeve.

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE

Përveç mbikëqyrjes së aktiviteteve të Qeverisë drejt përmbushjes së obligimeve për zbatimin e Planit të Integritimit Evropian të Kosovës 2008-2010, Komisioni për Integritime Evropiane ka edhe një rol specifik në shqyrtimin e projektligjeve gjatë fazës së amendamentimit. Ky komision është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha amendamenteve të projektligjeve nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e Unionit Evropian. Për të përmbushur këtë funksion, gjatë këtij viti, Komisioni ka shqyrtuar amendamentet e të gjitha projektligjeve që janë shqyrtuar në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, ky Komision është komision funksional për projektligjet që ndërlidhen me procesin e integritimeve. Gjatë vitit 2008 nuk është proceduar asnjë projektligj për të cilin Komisioni për Integritime Evropiane do të duhej të ishte komision funksional.



VIZITAT JASHTË SHTETIT

Në funksion të përmbushjes së detyrave dhe obligimeve që ka dhe për të përfituar përvojën dhe mbështetjen për procesin e integritimeve, Komisioni për IE gjatë vitit 2008, ka realizuar tri vizita të suksesshme jashtë shtetit. Vizita e parë, me ftesë të z. Neved Mimica, nënkryetar i Parlamentit të Kroacisë, është zhvilluar në Kroaci. Ndërsa, vizita e dytë me ftesë të znj. Jozefina Topalli, kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, është zhvilluar në Shqipëri. Në këto vizita, Komisioni është pritur nga zyrtarët më të lartë shtetëror të këtyre vendeve, prej të cilëve ka marrë zotimin për mbështetjen e tyre për Kosovën, në procesin e integritimeve evropiane. Gjithashtu, është arritur pajtueshmëri që të intensifikohen kontaktet dhe bashkëpunimi me këto vende, me qëllim të ofrimit të përvojave dhe mbështetjes së tyre për Integrim sa më të shpejt të Kosovës në strukturat euro-atlantike.



Në vazhden e dy vizitave të para dhe sigurimit të mbështetjes së mëtejshme nga institucionet e UE-së, nga 7-8 tetor Komisioni për IE ka vizituar Brukselin, ku anëtarët e tij kanë zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve të UE-së.

Në të gjitha këtë takime Komisioni ka prezantuar të arriturat e fundit të Kosovës në të gjitha fushat si dhe duke i falënderuar për mbështetjen e deritanishme, ka kërkuar që Kosova të mbështetet edhe në vitet në vazhdim, e cila edhe iu është premtuar nga mikpritësit.



TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA

Me qëllim të intensifikimit të përpjekjeve dhe gjetjes së mënyrave më të përshtatshme për Integrimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike, si dhe nxitjen e Qeverisë për përmbushjen e obligimeve për këtë proces, Komisioni për IE, me mbështetje të partnerëve të jashtëm ka organizuar një tryezë të rrumbullakët. Tema e kësaj tryeze ishte “Plani i Qeverisë për Integrimin 2008 - 2010: Roli i Kuvendit të Kosovës”, i cili është mbajtur më 6 Maj.

MONITORIMI I PROCESIT TË INTEGRIMEVE EVROPIANE

Që nga themelimi Komisioni për Integrimin Evropian, vëmendje të veçantë i ka kushtuar monitorimit të procesit të integrimeve evropiane, me theks të veçantë zbatimit të Planit për Integrimin Evropian 2008-2010. Për këtë qëllim për të parë progresin e arritur në këtë fushë, Komisioni ka mbajtur kontakte të rregullta me Agjencionin për Integrimin Evropian, si dhe ka ftuar rregullisht zv. Kryeministrin Hajredin Kuçi, dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës, për të raportuar para Komisionit. Përveç, përfaqësuesve të Qeverisë, për të diskutuar për ecurinë e procesit të integrimeve, Komisioni ka qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe ka ftuar përfaqësuesit e institucioneve të UE-së në Kosovë, në veçanti Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë.

Statistika

Komisioni gjatë vitit 2008

- Mbledhje të komisionit	25
- Vizita	3
- Raportimi i ministrave në takime	mbi 6
- Dëgjime publike	1

KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE



Zylfije Hundozi (AAK)
Kryetare e Komisionit



Bujar Bukoshi (LDK)
Zëvendëskryetar i Parë



Džezair Murati (7+)
Zëvendëskryetar i Dytë



Hydajet Hyseni (PDK)
Anëtar



Edita Tahiri (PDK)
Anëtare



Sabri Hamiti (LDK)
Anëtar



Fatmir Rexhepi (LDK)
Anëtar



Njomza Emini (AKR)
Anëtare



Nait Hasani (PDK)
Anëtar



Naser Rugova (LDD)
Anëtar



Branislav Grbić (SLS)
Anëtar



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati përthjes

038 211 186
sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Minire Hasani Administratore e Zyrës

Zyra N - 314, Kati III
038 211 850
minire.hasani@assembly-kosova.org

Ahtere Loxha Zyrtare e Lartë Ligjore

038 211 332
ahtere.loxha@assembly-kosova.org

Adelina Demolli Zyrtare Ligjore

038 213 801
adelina.demolli@assembly-kosova.org

Zyrtari nga NDI që mbështet Komisionin

Avni Zuka Zyrtar Legjislativ

Zyra N - 320, Kati III

038 212 532 azuka3@gmail.com
044 513 608

Webfaqja e Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

